



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**ENTI RREGULLATOR I ENERJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 206, Datë 11.12.2020**

**MBI**

**KËRKESËN E SHOQËRISË OST SH.A. PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË  
BORDIT TË ERE-S NR. 163, DATË 22.10.2020, “MBI APLIKIMIN E SHOQËRISË  
OST SH.A. PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT  
TË ENERJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2021”.**

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 180, datë 08.11.2017, si dhe nenit 15, 16 pika 2 dhe nenit 21, pika 2, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 131/4 Prot, datë 09.12.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, mbi rrëzimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. për rrëzimin e vendimit të bordit të ERE-s Nr 163, datë 22.10.2020,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria OST sh.a. me shkresën nr. 5686 Prot, datë 24.09.2020, paraqiti kërkesën për aplikim për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021, sipas dokumentacionit që OST sh.a. i kishte bashkangjitur kësaj shkrese.
- Pas shqyrtimit të aplikimit, bordi i ERE-s me vendimin Nr. 163, datë 22.10.2020 vendosi për “Mos fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a. lidhur me miratimin e tarifës së kërkuar prej 1.31 lekë/kWh për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021”.
- OST sh.a. me anë të shkresës nr. 6731, datë 09.11.2020, ka kërkuar rishikimin e vendimit Nr. 163 datë 22.10.2020, të bordit të ERE-s “Mbi aplikimin e shoqërisë OST sh.a. për miratimin e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021”.
- Në këtë kërkesë OST sh.a. deklaron se mosfillimi i procedurës për shqyrtimin e aplikimit ka një ndikim të qënësishëm në administrimin e shoqërisë, duke u lidhur ngushtë me hartimin dhe paraqitjen për miratim të Programit të Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë dhe treguesve kryesore afatmesëm dhe afatgjatë sipas afateve dhe kërkesave ligjore, si dhe në përgatitjen paraprake të nevojshme për ndërhyrje në sistemin e transmetimit gjatë vitit 2021, për të siguruar qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike.

- Kërkesa e OST sh.a. mbështetet në nenin 16, pika 5, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe nenin 16, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016 të bordit të ERE-s, ku përcaktohet:
  - Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar **prova të reja** që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.
- Kërkesa për rishikim, në kuptim të sa më sipër, është paraqitur nga subjekti i ligjitimuar për të paraqitur një kërkesë për rishikim, dhe brenda afateve ligjore të parashikuara më sipër.
- Në lidhje me paraqitjen e provave të reja, të tilla që të mund të çojnë bordin e ERE në marrjen e një vendimi të ndryshëm, analizojmë si në vijim, referuar kërkesave të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE.
  - OST sh.a. në kërkesën për rishikim, ka përcjellë dokumentat të cilat listohen si vijon:
    - Pasqyrat financiare janar-dhjetor 2019 (tabelë);
    - Pasqyrat financiare janar-shtator 2020 (tabelë);
    - Plani i Investimeve 2021 (raport + tabelë);
    - Raporti i rivlerësimit të asetëve OST 01.01.2019 (raport);
    - Referenca Shërbime Ndhimëse (raport + tabelë);
    - Tarifa 2019-2021 (tabelë).
- Dokumentacioni lidhur me Pasqyrat financiare janar-dhjetor 2019, Pasqyrat financiare janar-shtator 2020, për të cilat OST sh.a. vlerëson sa është përcjellë gjatë periudhave ushtrimore të cituara në kërkesën për rishikim, kanë qenë në kuadër të plotësimit të kërkesave për informacion të ERE-s drejtuar shoqërisë mbështetur në legjislacionin në fuqi, lidhur me:
  - shqyrtimin e planit të investimeve të vitit 2020, për të cilën bordi i ERE tashmë është shprehur me vendimin Nr. 169, datë 03.11.2020,
  - detyrimeve të kushteve të licencës për raportimin periodik të pasqyrave financiare,
  - monitorimin dhe vlerësimin e aktivitetit ushtrimor të operatorit të sistemit të transmetimit.
- Konstatohet se llogaritë kontabël të përcjella në tabelat excel të Pasqyrave financiare janar-dhjetor 2019 dhe Pasqyrave financiare janar-shtator 2020, vijojnë të mos paraqiten sipas “Sistemit të njehsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike” të miratuara me vendimin nr. 244, datë 26.11.2018 të bordit të ERE, siç dhe vlersuar në paragrafin 11, faqja 4, të konstatimeve të vendimit nr.163/2020.
- Lidhur me gjendjen e kredive që OST sh.a. ka ndaj Ministrisë së Financave dhe KESH sh.a., shoqëria në kërkesën për rishikim deklaroi se ato janë lehtësisht të verifikueshme në pasqyrat financiare të periudhave ushtrimore, ndërkohë që në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, shpenzimet financiare që OST sh.a. ka ndaj palëve të

lartpërmendura, nuk paraqiten të ndara kundrejt principalëve të huave afatgjata nga ato afatshkurtra, dhe nuk mundësohet analiza e kostos së borxhit afatgjatë të marrë në konsideratë nga OST sh.a. në zbatim të përcaktimeve të pikës 4.6, të nenit 7, të Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit, kusht thelbësor i vlerësimit të drejtë mbi koston mesatare të ponderuar të kapitalit (WACC) të aplikuar prej saj si komponent i llogaritjes së kthimit të lejuar mbi Bazën e Rregulluar të Aseteve të transmetimit.

- Lidhur me Dokumentacionin e dërguar në këtë kërkesë, mbi Planin e investimeve për vitin 2021, ashtu si dhe konstatuar në vendimin 163/2020, të bordit të ERE-s, duhet të ishte paraqitur në ERE si një aplikim më vete, mbështetur në përcaktimet e *“Procedurave të Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga Operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 135, datë 06.09.2017”*.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me Planin e investimeve për vitin 2021, konstatohet se është paraqitur vetëm një informacion narrativ dhe tabelar, ndërkohë që në gjermën f), të pikës 2, të nenit 8 dhe gjermës d), të pikës 4, të nenit 8 të rregullores së *Procedurave të Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga Operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike* përcaktohet se në planifikimin e investimeve, operatori duhet të bazohet dhe të respektojë Analizën e plotë të kosto përfitimit, sigurimin e efektivitetit të kostove të projektit dhe kostove të argumentuara, përfshirë plan investimesh të detajuar me afatet përkatëse (Studim fizibiliteti duke përfshirë vlerësimin e impaktit mjedisor) si dhe të shoqërojë këtë plan me relacione argumentuese lidhur me analizën e plotë të përfitimit të koston që vërteton efektivitetin e çdo projekti të planifikuar dhe justifikon kostot që lidhen me to.
- Lidhur me dokumentacionin e dërguar për Raportin e rivlerësimit të aseteve të OST 01.01.2019, konstatohet se në këtë raport jepet vlera e drejtë e Aktiveve në pronësi të Shoqërisë OST sh.a., së bashku me përcaktimin e jetës së dobishme më datë 31 Dhjetor 2018”.
- Konstatohet se në këtë raport nuk jepet informacion lidhur me gjëndjen e aseteve deri me datë 31.12.2019, por vetëm parashikime mbi periudhën 2019-2023.
- Asetet e paraqitura në këtë raport, janë të rivlersuara dhe jo të paraqitura sipas kostove historike në zbatim të përcaktimeve të pikës 4.2.2, të nenit 7, të Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike.
- Lidhur me dokumentacionin mbi Referencat e Shërbimeve Ndhmëse vlerësojmë se çmimet e tregut të vendeve të ENTSO - E, mund të mos jenë të aplikueshme në kushtet e vendit tonë, për arsye se rezervat automatike dhe manuale, kanë sasi dhe vlerat rrjedhimisht të ndryshme si në volumin e transaksioneve energjitike të cilat janë tepër të larta, por dhe në profilet apo tipet e gjenerimit.
- Nga analiza e të dhënave financiare të dërguara deri më tani, vlerësohet se tarifa e përdorimit të rrjetit në fuqi, i ka krijuar OST sh.a. rezerva të ardhurash të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve operative ku përfshihet dhe prokurimi i shërbimeve ndihmëse në tregun e lirë.
- OST sh.a. në zbatim të përcaktimeve të pikës 17 të nenit 5 të Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike, duhet të realizojë dhe të

planifikojë shpenzime në mënyrë të kujdesshme dhe që lidhen vetëm me aktivitetin e licencuar, për të minimizuar sa më shumë efektet apo pasojat që ato mund të sjellin ndaj treguesve financiar të shoqërisë.

- Lidhur me tabelat e Tarifës 2019-2021, e përcjella në kërkesën për rishikim, evidentohen vlerat mbi realizimin e treguesve financiar të vitit 2019, pritshmëritë mbi realizimin e këtyre treguesve për vitin 2020, si dhe parashikimet mbi komponentet e të ardhurave të kërkuara për vitin 2021.
- Nga analiza e të dhënave të paraqitura në këto tabela, evidentohet se zërat e OPEX janë paraqitur në total dhe jo në formë analitike dhe të sintetizuara për vitet 2019-2020 dhe parashikimet për vitin 2021.
- Operatori i sistemit të transmetimit duhet të paraqesë gjithë kostot me saktësi deri në 100,000 lekë, kusht ky i domosdoshëm për vlerësimin e opexit i cili mundëson identifikimin e kostove të drejta dhe të arsyeshme që janë realizuar por dhe që parashikohet të realizohen, dhe që do të shërbejnë për llogaritjen e tarifës së përdorimit të rrjetit të transmetimit.
- Tabelat e Tarifës 2019-2021 nuk janë të shoqëruar me informacion të plotë mbi treguesit teknik, ekonomik dhe financiar si dhe llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve për të gjithë shoqërinë si një kusht thelbësor dhe i domosdoshëm për vlerësimin e opexit dhe identifikimin e kostove të drejta dhe të arsyeshme që janë realizuar por dhe që parashikohet të realizohen, të cilat shërbejnë për llogaritjen e tarifës së përdorimit të rrjetit të transmetimit në zbatim të pikës 11, të nenit 5 të Metodologjisë së tarifave.
- Kërkesat për paraqitjen e një informacioni të plotë të realizimit të treguesve teknik, ekonomik dhe financiar për llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve do të mundësonin vlerësimin e tyre nga palët e interesuara, kusht i përcaktuar dhe në pikën 14 të nenit 5 të Metodologjisë.
- Gatishmëria e OST sh.a. për të përcjellë informacionet plotë lidhur me mangësitë e konstatare në aplikimin e tarifave, nuk mund të justifikojë mosparaqitjen e dokumentacionit dhe informacionit baze të cilët kanë shërbyer për parashikimin dhe vlerësimin e komponentëve të të ardhurave të kërkuara prej saj, kërkesa të cilat janë të domosdoshme dhe të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
- ERE në çdo vendimarrje ka vlerësuar rast pas rasti mbi përmbajtjen e aplikimeve respektive duke vijuar me fillimin e procedurave të miratimit të tarifës së transmetimit, pasi ka konstatuar se janë përmbushur kriteret e paraqitjes së aplikimeve për tarifa, mbështetur në përcaktimet e Rregullores së organizimit funksionimit dhe procedurave të ERE, si dhe Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë.
- ERE gjatë shqyrtimit dhe analizës së një aplikimi, kërkon detaje dhe sqarime specifike për elementë të të ardhurave të kërkuara në vijim të analizës së tarifës së propozuar mbështetur në përcaktimet e Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE, si dhe Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë.
  - Procesi i rishikimit të një vendimi nga ana ERE në zbatim të përcaktimeve të pikës 1 të nenit 16 të Rregullores së organizimit funksionimit të procedurave të ERE, kryhet në rast se i licencuari ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet

materiale të konstatuara, ndërkohë që nga analiza e dokumentacionit të përcjellë nga OST në këtë kërkesë, nuk është konstatuar asnjë provë e re.

- Shoqëria ka një eksperiencë të konsiderueshme lidhur me procedurat, formatin e paraqitjes së një aplikimi të plotë në aspektin argumentues dhe dokumentues, i cili mundëson kryerjen e analizave dhe vlerësimeve mbi tarifën e propozuar.
- Në rast se do të aplikohet një tarifë e pambështetur në llogaritje të sakta dhe transparente ndaj përdoruesve të rrjetit dhe e pabazuar në parimet rregullatore të Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimi të energjisë elektrike, stabiliteti financiar i tregut të energjisë do të çenohej dhe do të përballej më vështirësi të theksuara të cilat mund të përshkallëzoheshin në humbje financiare të mëtejshme për shoqëritë e rregulluara dhe rritje të kostove operative të paarsyeshme për përdoruesit e tjerë të rrjetit të transmetimit.
- Në kushtet aktuale, nëse ERE do të vepronte sipas arsytimit të paraqitura në kërkesën për rishikim të OST sh.a. koha për vlerësimin e këtij aplikimi do të ishte e pamjaftueshme dhe përtej afateve të përcaktuara në pikën 5, të nenit 22, të Rregullores së organizimit funksionimit dhe procedurave të ERE.

Pas vlerësimit të kërkesës për rishikimin e vendimit Nr. 163/2020, të bordit të ERE nga OST sh.a., konstatohet se shoqëria nuk ka përcjellë asnjë informacion apo dokumentacion në cilësinë e provës së re të tillë që të cojë bordin e ERE në marrjen e një vendimi të ndryshëm.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s Nr. 163, datë 22.10.2020, mbi “Mos fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a. lidhur me miratimin e tarifës së kërkuar prej 1.31 lekë/kWh për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021”.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë shoqërinë OST sh.a për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**